

VENDIM
Nr.882, datë 5.11.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR,
PËRKATËSISHT, PËR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS DHE MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE
SPORTEVE, PËR PAGESËN E DETYRIMEVE NDAJ KOMISIONIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2010 të shtohet fondi prej 82 000 000 (tetëdhjetë e dy milionë) lekësh, për shlyerjen e detyrimit ndaj Komisionit Europian, i ndarë, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës 77 700 000 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind mijë) lekësh;

b) Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 4 300 000 (katër milionë e treqind mijë) lekësh.

2. Fondi prej 82 000 000 (tetëdhjetë e dy milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha